

# PULSAR KPE - Diskutim Inteligent Ndëraktiv “Edukimi kontabël në sektorin publik: shembuj të mirë të programeve mësimore, kurseve online dhe mjeteve mësimore”.

Ekipi KPE, PULSAR  
23 qershor 2021



**CFRR** >>  
Centre for Financial  
Reporting Reform




**PULSAR** 

Public Sector Accounting and Reporting Program

---

PULSAR Program is co-funded by:



 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

---



## Përmbajtja e seancës

Informacion i përgjithshëm i materialeve të shpërndara gjatë zgjerimit të TT SNKSP, si edhe i programeve të tjera mësimore të bazuara në SNKSP

Shembull i zgjerimit të formimit në Universitetin Kombëtar Ekonomik të Kievit “Vadym Hetman” (Ukrainë)

# Baza për zgjerimin e TT SNKSP:



Certifikata e ACCA-së në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik – e njohur si IPSAS Cert –

<https://www.accaglobal.com/us/en/qualifications/glance/certificate-in-international-public-sector-accounting-standards-/overview.html>

IPSAS Cert – është zhvilluar enkas për të ndihmuar nxënësit të kapërcejnë sfidat në zbatimin e SNKSP-ve:

- duke parë kërkesat themelore të SNKSP-ve me të drejta dhe detyrime të konstatuara, standard pas standardi,
- duke ofruar udhëzime mbi mënyrën si të përdoren në praktikë SNKSP-të,
- duke shpjeguar dallimin midis SNKSP-ve monetare dhe SNKSP-ve me të drejta dhe detyrime të konstatuara
- duke dhënë një informacion të përgjithshëm se si përdoren SNKSP-të në mbarë botën.

# Struktura e kursit online IPSAS Cert:

---

Ky kualifikim bazohet në dhjetë module, ku secili fokusohet te një aspekt i SNKSP-ve ose te një grup SNKSP-sh të lidhura. Modulet janë:

- Moduli 1: Natyra dhe operacionet e BSNKSP-së dhe Kuadri Konceptual i BSNKSP-së.
- Moduli 2: Paraqitja e pasqyrave financiare dhe politika kontabël.
- Moduli 3: Performanca financiare.
- Moduli 4: Kontabilizimi i aktiveve dhe detyrimeve – pjesa 1
- Moduli 5: Kontabilizimi i aktiveve dhe detyrimeve – pjesa 2
- Moduli 6: Konsolidimi
- Moduli 7: Standardet e dhënies së informacioneve shpjeguese dhe tema të tjera
- Moduli 8: SNKSP me baza monetare
- Moduli 9: Zbatimi për herë të parë i SNKSP-ve me të drejta dhe detyrime të konstatuara
- Moduli 10: Propozimi mi ardhshëm për ndryshim.



# E drejta e përdorimit të materialeve mësimore të kursit



- Materialet mësimore si edhe provimet dhe testet janë të mbrojtura nga kopjimi apo shkarkimi, që do të thotë se studentët mund të punojnë me këto materiale vetëm gjatë kohës që kanë të drejtë të hyjnë në kursin online të ACCA-së.
- Materialet e kursit online janë në anglisht dhe këto materiale nuk janë përkthyer në gjuhët e programit PULSAR, pra vetëm pjesëmarrësit e kursit TT që e ndoqën në anglishte morën një kurs të plotë materialesh mësimore, të plotësuara me një paketë dokumentesh të përgatitura enkas për kursin TT

## Materiale shtesë

- Prezantim PowerPoint për të 10 modulet, ku prezantohen të dhëna të përmbledhura nga materialet mësimore online dhe ndjekin programin e lëndës IPSAS Cert.
- programi i kursit;
- një provim ushtrimor (15 pyetje me përgjigje me zgjedhje)
- ushtrime praktike (dhe zgjidhjet)
- vlerësime shtesë (dhe zgjidhjet)
- udhëzuesi për instrukturin.



# Kualifikimet alternative të bazuara në SNKSP:



- Instituti i Autorizuar i Financave dhe Llogaridhënies Publike (CIPFA) është një organizatë e fokusuar në sektorin publik dhe është i vetmi organ i profesionit kontabël në botë që i është dedikuar vetëm financave publike.
- Kualifikimet e CIPFA-s:
  - Kualifikimi Kontabël Profesional (CIPFA PQ),
  - Kualifikimi Profesional Ndërkombëtar në Menaxhimin e Financave Publike (IPFM PQ),
  - Kualifikime në SNKSP, përfshirë Diplomën e CIPFA-s në SNKSP dhe Certifikatën e CIPFA-s në SNKSP.

<https://www.cipfa.org/qualifications>



**Faleminderit!**